



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS - RTK

NENI 1

QËLLIMI I MEMORANDUMIT TE BASHKEPUNIMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është zhvillimi i bashkëpunimit afatgjatë në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Radio Televizionit të Kosovës - RTK në promovimin dhe dokumentimin e aktivitetit të plotë vjetor të MKRS-së dhe institucioneve të varësisë në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore si element kryesor i sjelljes së vlerave kulturore tek publiku kosovar, pasurimin e programit kulturor e artistik të RTK-së përmes raportazheve, dokumentareve, emisioneve, kronikave, mbulimit të ngjarjeve vjetore të të gjitha niveleve të MKRS, zhvillimin e kapaciteteve orkestrale e korale, realizimin e Festivalit të Këngës në RTK si dhe themelimin e kanalit televiziv për artin dhe kulturën.

NENI 2

PALËT

Qëllimi i Memorandumi të Bashkëpunimit do të përmbushet nga:

- 2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (më tutje MKRS); dhe
- 2.2. Radio Televizioni i Kosovës (më tutje RTK)
(në tekstin e mëtejshëm: Palët).

NENI 3

OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit merr përsipër obligimet si në vijim:

- 3.1. Transferon tek RTK mjetet financiare në vlerë prej 300,000 euro për vitin 2023, 250,000 euro për vitin 2024 dhe 200,000 euro për vitin 2025 për zbatimin e qëllimit të këtij Memorandumi;
- 3.2. Mjetet financiare si në pikën 3.1 i transferon nga buxheti i Departamentit të Kulturës, kodi 805, kategoria subvencione dhe transfere;
- 3.3. Në fillim të vitit përkatës i siguron RTK-së programin e aktiviteteve kryesore kulturore dhe të trashëgimisë kulturore në kuadër të kalendarit kulturor vjetor, programet e institucioneve të varësisë të kulturës, listat e përfituesëve të thirrjeve publike në momentin e publikimit të tyre dhe aktivitetet tjera të diplomacisë kulturore në nivelin qeveritar. Për çdo përditësim të ngjarjeve apo detajeve tjera informon RTK-në me kohë;
- 3.4. Ofron bashkëpunim të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të MKRS-së në qasje për xhirim profesional të premierave, huazim të materialit të xhiruar për promovim në RTK dhe huazim të filmave dhe materialeve të tjera të financuara nga institucionet e MKRS-së në përputhje me ligjin e të drejtave të autorit dhe legjislacionin tjetër në fuqi;
- 3.5. Siguron RTK-së, se nuk do të ketë implikime të të drejtave Autoriale që në të ardhmen mund t'i shkaktojnë RTK-së pasoja juridike;
- 3.6. Përcjellë në vazhdimësi dhe monitoron zbatimin e Memorandumi të bashkëpunimit.

NENI 4

OBLIGIMET E RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS – RTK

Radio Televizioni i Kosovës merr përsipër obligimet si në vijim:

- 4.1. Merr përsipër incizimin profesional, produksionin dhe post-produksionin e ngjarjeve premierë, shfaqjeve, koncerteve, shfaqjeve operistike, hapjeve të ekspozitave dhe formave të tjera

të institucioneve të MKRS-së, një kopje e së cilës i dorëzohet institucionit përkatës për nevoja të arkivimit.

4.2. Përcjellë dhe promovon aktivitetet kulturore dhe të trashëgimisë kulturore të organizuara nga MKRS dhe institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore në varësi të MKRS, përmes formateve të ndryshme profesionale, duke përfshirë reportazhet e metrazhit të shkurtër/mesëm/gjatë, dokumentarët, emisionet kulturore, emisionet kulturore dhe edukative për fëmijë dhe moshë më të reja, kronikat e ndryshme dhe incizimet profesionale me regji specifike për premierat/hapjet e ekspozitave, etj të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore të nivelit qendror dhe lokal;

4.3. Përcjellë dhe promovon brenda mundësive me të gjitha formatet e lartëcekura aktivitetet kulturore dhe trashëgimisë kulturore në kuadër të kalendarit kulturor të MKRS-së dhe institucioneve vartëse të kulturës;

4.4. I ofron MKRS-së qasje në arkivin e RTK-së për nevojat e aktiviteve të saj në kuadër të Kalendarit kulturor dhe aktiviteteve tjera kulturore të ndërlidhura;

4.5. Ndërmerr të gjitha veprimet për zhvillimin e Festivalit të Këngës në RTK, në baza vjetore;

4.6 Merr përsipër themelimin e kanalit televiziv për artin dhe kulturën ku edhe do të transmetoj të gjitha materialet televizive të prodhuara si dakordim i këtij memorandumi;

4.7. Ndërmerr të gjitha veprimet për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve orkestrale muzikore të RTK në nivel ligjor dhe praktik;

4.8. Merr përsipër pasurimin e skemës programore me emisione speciale dhe reportazhe të realizuara në lidhje me datat e rëndësishme, subjektet dhe temat e veçanta të kulturës dhe trashëgimisë kulturore të MKRS sipas ngjarjeve të realizuara në kuadër të këtij Memorandumi;

4.9. Sipas mundësive përcjell ngjarjet e institucioneve komunale publike të kulturës dhe të organizatave të artistëve të skenës së pavarur që financohen përmes skemës së granteve të kulturës;

4.10. Sipas mundësive bënë promovimin dhe mbulimin e aktiviteteve të diplomacisë kulturore të Qeverisë së Kosovës që realizohen jashtë shtetit;

4.11. Përgatit raport të realizimit të pikave të mësipërme të memorandumit në bazë vjetore;

4.12. Obligohet të bëjë raport narrativ dhe raport financiar vjetor për çështjen e shpenzimit të buxhetit si në Nenin 3, paragrafi 3.1 të këtij Memorandumi dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi përmbyll obligimet për arsyetimin e shpenzimit të buxhetit me dëshmitë e kontratave, faturave dhe transaksioneve bankare, sic e parasheh legjislacioni në fuqi.

4.13. Të gjitha këto ngjarje, RTK do të i mbuloj në mbështetje ligjore të cilat i lejohen nga Ligji nr.04/L-046 për RTK-në dhe aktet tjera nënligjore.

NENI 5 ZBATIMI

5.1. Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e tyre të përcaktuara në këtë Memorandum, në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi. Palët përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në zbatimin e obligimeve në mbarëvajtjen e punëve, deri në momentin e realizimit të qëllimit të këtij Memorandumi.

NENI 6
MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E
PAPARISHIKUARA

- 6.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.
- 6.2. Nëse zbatimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë Mbinatyrore Vis maior dhe rrethanave të tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

NENI 7
AMANDAMENTIMI

- 7.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandumin e Bashkëpunimit në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandumi, të nënshkruar nga palët do të konsiderohen si pjesë të integruara në këtë dokument.
- 7.2. Listimet me ngjarje Kulturore të cilat do jenë në vitin pasues, e që RTK do të i ndjek dhe të bëjë relizimin dhe transmetimin e tyre ashtu siç parashihet në Nenin 4 të këtij Memorandumi, do të i bashkëngjiten këtij Memorandumi në formë Aneks-Memorandumi për çdo vit sa të jetë i vlefshëm Memorandumi.
- 7.3. Aneks-Memorandumet do të jenë valide pas nënshkrimit nga të dyja palët.

NENI 8
ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

NENI 9
AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2023-2025, me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera me marrëveshje të dyanshme.

NENI 10
KOPJET DHE GJUHA E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

NENI 11
HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.



Hajrulla ÇEKU

Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

PALËT NËNShKRUERE

Besnik BOLETINI,

Kryetar i Bordit të RTK-së

Nënshkruar më 09 / 02 / 2023
Prishtinë